



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT



Mekanizmi Kombëtarë për Parandalimin e Torturës

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201401357/2

Tiranë ___/___/2014

Lënda: *Rekomandohet përmirësimi i kushteve të trajtimit të të paraburgosurve në I.E.V.Penale Elbasan.*

Drejtuar: **Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve
Z. Artur Zoto**

TIRANË

**Drejtorit të I.E.V.Penale
Z. Eugert Salla**

ELBASAN

Të nderuar Zotërinj,

Avokati i Popullit në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, kreu një inspektim të përgjithshëm në Institucionin e Paraburgimit Elbasan, më dt. 23.07.2014. Në përbërje të grupit inspektues bënë pjesë Alfred Koçobashi (drejtues i grupit inspektues), Irena Taga, Alma Alibali N/Komisioner pranë Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës së bashku me ekspertët e Shoqatës Përthyerje, në zbatim të marrveshjes së bashkëpunimit të Institucionit të Avokatit të Popullit si Mekanizëm Kombëtar Parandalues në kuadër të *OPCAT-it* me OJF te specializuar të fushës.

Në përfundim të këtij inspektimi, pasi u njoh me të gjithë konstatimet e grupit inspektues, si dhe me problematikat e ngritura nga ana e të paraburgosurve, Avokati i Popullit ka detyrimin kushtetues dhe ligjor t'ju parashtrojë konkluzionet përfundimtare, duke ju referuar si vijon:

Kjo ishte vizita e dytë monitoruese e Avokatit të Popullit në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Elbasan. Me urdhër nr. 1201/1, datë 27.02.2012 të Ministrit të Drejtësisë, "Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale Elbasan kategorizohet institucion paraburgimi." Në përgatitjen e këtij raporti, nga grupi monitorues u përdor informacioni i mbledhur në I.E.V.P. Elbasan nga kjo vizite, nga kontakti me drejtuesin e institucionit dhe

përfaqësues të tjerë të administratës së këtij institucioni, nga kontakti me vetë të paraburgosurit, vizita në ambiente të brendshme të paraburgimit, nga verifikimi i të dhënave në rregjistrat dhe dosjet e I.E.V.P.-së, si dhe nga krahasimi i këtyre të dhënave me kërkesat e aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

Shënime paraprake

Në përputhje me procedurën e zhvillimit të monitorimit, grupi monitorues zhvilloi fillimisht takimin me drejtuesin e institucionit. Nga ana e drejtuesit të institucionit u shpreh gadishmëria dhe disponibiliteti për të realizuar të gjitha kërkesat e grupit monitorues.

Në takimin me drejtorin e IEV Elbasan, Z.Eugert Salla grupi monitorues u informua për situatën e përgjithshme në institucion. IEVP Elbasan është një institucion i ndërtuar në 2010-ën dhe infrastruktura e tij është e një standarti të lartë. Kapaciteti institucionit 120 të dënuar, shtretër 143 dhe aktualisht deri në dt 23.07.2014 ndodheshin 212 të paraburgosur. Në institucion kishte mbipopullim dhe 40% e të dënuarve flinin në tokë me dyshekë; Institucioni ndahet në dy seksione të mëdha A dhe B, midis këtyre seksioneve gjenden dhoma aktivitetesh dhe biblioteka. Seksionet ndahen në sektore dhe brenda çdo sektori ka klasa për aktivitete të përbashkëta. Përpara hyrjes në seksione kishte 2 dhoma observimi dhe 2 dhoma tranziti. Seksioni A për të dënuar mbi 21 vjec dhe seksioni B për 18-21 vjecarët: Të paraburgosur që ishin të vecuar me masën disiplinore të vecimit ishin 2. Kishte 6 të arrestuar me probleme të shëndetit mendor, por nuk ekzistonte nje seksion i vecantë për ta; Shtetas me kombësi të huaj nuk ka vec një i paraburgosur Dritan Mesadrial, godina B, kati II, dhoma I, i cili pretendon se është me nënshtetësi Bullgare dhe të trajtohet si i tillë por nga dokumentat që ka rezulton me nënshtetësi Shqipëtare. Organika e stafit ishte e plotësuar. Institucioni ishte i pajisur me sistem ventilimi dhe ngrohjeje qendrore, si dhe me sistem te mbrojtjes kundër zjarrit. Gjithashtu institucioni kishte ambient sportiv (fushë futbollit/kalçeto), lavanteri, kuzhinë moderne, si dhe ambient për dhomë kulti, bibliotekë, spital/infermieri, si dhe ambient palestine por ende jo funksional. Sektorët, në të cilët ishin dhe dhomat e banimit të të paraburgosurve, ishin të organizuar në këto ambiente: dhoma banimi, ambiente të përbashkëta, dhomë këshillimi, klasa, banjë e jashtme e përbashkët, ambient dushi për nje person, magazinë. Dhomat e banimit ishin projektuar për 1, 2, 3, 4 e 5 persona. Dhomat e banimit ishin të pajisura të gjitha me ambient banjoje. Problematika me e madhe sipas mendimit të drejtorit të institucionit dhe shefit të sigurisë ishte mbipopullimi i këtij institucioni i cili ulte dhe cilësinë e shërbimeve për të paraburgosurit. Nga vizita në institucion në sektorin A dhe B dhe seksionit të vëzhgim/vecimit dhe vizitat në mjediset e takimeve me familjet, kuzhinës, si dhe bisedat me të arrestuarit, rezultoi se:

1. Trajtimi

Grupi i monitorimit pati për objektiv të punës së tij mbledhjen e informacionit lidhur me trajtimin e të paraburgosurve, në identifikimin e rasteve të përdorimit të torturës, trajtimit degradues e diskriminues, përdorimit të forcës fizike tej kufijve të parashikuar me akte normative apo të presionit psikologjik ndaj kësaj kategorie, si edhe të rasteve të marrjes së masave disiplinore të "vecimit

nga aktivitetet e përbashkëta“. Nga informacioni i marrë, si nga drejtuesit e institucionit, ashtu edhe nga bisedimi në grup dhe në privatësi me të paraburgosurit, grupi monitorues nuk konstatoi ndonjë rast torture apo përdorimi të tepruar të forcës apo dhunë psikologjike nga ana e personelit të I.E.V.P.-së Elbasan ndaj të paraburgosurve.

Ankesat që u paraqitën në momentin e inspektimit kishin të bënin më shumë me mbipopullimin e dhomave dhe hapsira e kufizuar, cilësinë e ushqimit, mungesa e detergjenteve, mungesa e dusheve, mungesë medikamentesh mjeksore si dhe mungesa e aktiviteteteve për regjimin e sektorit A dhe hapsirave si klasa aktivitetesh, bibliotek dhe palestër brenda regjimit ashtu sikurse janë në sektorin B.

2. Infrastruktura/Dhomat e banimit dhe kushtet materiale

Dhomat e banimit brenda regjimit akomodojnë nga 1 deri në 4 persona në dhomë. Institucioni aktualisht ka vetëm 143 shtretër për këtë arsye jo të gjithë të paraburgosurit kanë krevat, disa flenë në dyshek. Inventari nëpër dhoma është i plotësuar (ka karrige, tavolinë, dollap etj). Dhomat janë të përmasave të ndryshme por kryesisht të vogla në kubatur. Kishte dhoma me dy shtretër dhe më shumë ku në të gjitha dhomat kishte nga 1 e deri në 2 të dënuar që flinin me dyshek përtok. Kishte dhe dhoma me një të dënuar ku dhoma ishte e vogël me hapsirë sa për një krevat. Tualete ishin nëpër dhoma dhe në kushte shumë të mira.

Në dhoma ka ndricim natyror dhe artificial. Dritaret janë të mëdhaja dhe nuk pengojnë dritën e diellit dhe futjen e ajrit të pastër. Dhomat të pajisura me orendit e nevojshme si tavolin, karrige dhe dollap. Carcaftë, jastekët dhe batanijet në shumicën e rasteve ishin sjellë nga familjarët. Dyshekët ishin prej sfungjeri dhe në kushte të mira. Në disa prej qelive u ngrit si problem hapja e nderresave për tu tharë në dritare. Këto nuk lejoheshin për shkak se pengoninurvejimin me kamera.

Furnizimi me ujë të rrjedhshëm ishte siguruar, gjë që bënte të mundur aksesin e personave për të kryer normalisht nevojat e tyre. Megjithëse, në disa raste, pati ankesa, për mungesën e ujit të ngrohtë dhe veçanërisht në mjediset e observim/veçimit, për moslejimin të bërjes së dushit.

Gjatë dimrit ngrohja realizohet me kaldajë qëndrore ndërsa në verë nuk ka një mjet ftohje që të plotësojë kërkesat e të gjithë institucionit.

Për sa i përket pajisjeve elektroshtëpiake kishte dhoma ku nuk mungonin ato por këtu pati dhe shumë ankesa nga ata të cilët nuk mund të merrnin një pajisje si TV dhe frigorifer nga të afërmit sepse nuk i kishin mundësit për ta blerë atë dhe për këtë i kufizonte ligji në fuqi i Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, nr. 3895, datë 09.04.2013, në mjediset e banimit, lejon vetëm pajisjet që blihen nga institucioni me një komision të posaçëm. Këto pajisje mund të blihen nga të burgosurit/paraburgosurit nga institucioni. Nuk mungonin mjediset e jashtme të cilat ishin me një hapësirë të kënaqshme dhe përdorshin për aktivitete sportive si futboll, basketboll etj. Madje vetë institucioni organizonte spartakiada të ndryshme mes ekipeve.

Biblioteka ishte e pasur dhe ofronte larmishmëri librash. Në kushte shumë të mira dhe e pasur. Ajo ndodhej mes sektorëve A dhe B dhe shfrytëzohej nga të dy seksionet pamvarësisht se këtu pati ankesa nga sektori A se ata nuk kishin të njejtin akses si sektori B. Nuk mungonin hapësirat e kuleteve fetare të të dy besimeve ortodoks dhe të krishterë. Këto salla ishin të pajisuar shumë mirë dhe aty ofroheshin të gjitha ritet fetare për të paraburgosurit ku në raste festash fetare organizoheshin dhe aktivitete të mbështetura nga këto institucione. Një ambient tjetër në këtë institucion është dhe salla e takimeve e organizuar posaçërisht për takimet me fëmijët e vegjël. Kjo sallë është e pajisur më së miri me të gjitha orëditë e nevojshme si karrige, tryezë dhe në mure janë pikturuar të gjithë personazhet e filmave me kartona për fëmijë. Megjithatë nga konstatimet e bëra kjo sallë takimesh akoma nuk kishte filluar të funksiononte më së mirë për atë qëllim.

3. Higjena:

Mjediset e korridoreve, dhomat e takimit, ambientet e përbashkëta, banjat dhe kuzhina e institucionit ishin të pastra dhe të higjenuara. Qelitë janë të pajisura me tualete. Duset janë të përbashkëta ku çdo sektor ka 4 dushe por higjena në dushe nuk ishte shumë e mirë në momentin e inspektimit. Institucioni i lejon të paraburgosurit që të bëjnë dush një herë në javë (planifikuar me kalendar), por nga intervistat tona duset më shumë bëheshin në tualetet e dhomave dhe kjo u konstatua dhe gjatë inspektimit të dusheve sepse ato ishin të thata dhe mbanin erë të keqe. Të paraburgosurit kanë bërë kërkesë që të shpeshtohet bërja e dusheve por kërkesa e tyre është refuzuar. Higjena e ndërresave si çarçafët, jastëkët dhe batanijet e të paraburgosurve në shumicën e rasteve u janë sjellë nga familjarët. Ato së bashku me rrobat personale të të paraburgosurve dërgohen në shtëpitë e tyre dhe lahen nga familjarët. Problematike shfaqet situata në dhomat e observimit për sa i përket higjens. Ato e kanë tualetin e përbashkët por nuk ju ofrohet bërja e dusheve dhe kjo mund të bëjë që të paraburgosurit që gjenden në këto ambiente të kalojnë një periudhë deri në 10 ditë pa bërë dush.

4. Kuzhina

Nga vizita në kuzhinën e IEVP-së u vu re që është e madhe dhe mjaft moderne. Ushqimi i përgatitur ishte i cilësisë së kënaqshme dhe pastër. Në të punon një kuzhinier dhe një ndihmës kuzhinier. Ambientet e saj janë të pastra. Në kuzhinë është afishuar menuja ditore. Gramaturat dhe kaloritë janë brenda standarteve. Kampionët e ushqimeve të gatuar një ditë më parë ruhen në kushte frigoriferike. Jo të gjithë të dënuarit e konsumojnë ushqimin në institucion, pjesa më e madhe e tyre e alternojnë atë me ushqimin që sjellin familjarët. Nuk ka raste të refuzimit të ushqimit. Një ambient i vacant i këtij institucioni Brenda kuzhinës ishte dhe reparti i prodhimit të ëmbëlsirave i cili ishte mjaft modern dhe i pajisur me të gjitha mjetet e nevojshme. Për fat të keq nuk funksiononte si kuzhinë për shkak të mungesës së fondeve për asortimentet e nevojshme pasi buxheti është i limituar.

5. Orari veprimeve dhe aktiviteteve

Orari i veprimeve, përfshirë këtu zgjimin, rregullimin e pastrimin e dhomave dhe ambientit të përbashkët, punës edukative e profesionale etj, ishte i afishuar.

Në lidhje me ajrimin, përvec bisedës me të paraburgosurit, u kërkua informacion nga stafi dhe rezultoi se në sektorin A dhe B të paraburgosurit qëndrojnë 3 orë në ajrim, 2 orë paradite dhe 1 orë pasdite. Dy orët e paradites shfrytëzohen për aktivitete fizike, kryesisht futboll. Jo të gjithë të paraburgosurit bëjnë aktivitete në klasa. Psh. Në godinën A problemi qëndronte se klasat nuk ishin Brenda në regjim si në godinën B. Aty ishte vetëm një sallë e vogël këshillimi në të cilën ishte e pamundur që të zhvillohej aktivitete me më shumë se 3 veta. Sipas të paraburgosurve ata kishin dëshirë të përfshiheshin në shumë aktivitete por kjo nuk ndodh jo për shkak të mungesës së dëshirës së të paraburgosurve por për shkak se stafi i punonjësve social nuk ka klasa me hapsira të mjaftueshme.

Nga takimi me stafin e sektorit të kujdesit social u vu re një komunikim dhe bashkëpunim shumë i mirë. Ata na informuam për aktivitetet dhe programet që zbatoheshin në institucion si dhe pamë me zgjedhje disa dosje psiko-sociale të të paraburgosurve. Punonjësit e sektorit të kujdesit social ishin brenda në të gjitha seksionet gjatë vizitës sonë dhe na shoqëruan përgjatë vizitës. Ata kishin programe individuale të trajtimit për të dënuarit si dhe organizonin aktivitete të përbashkëta me të dënuarit, kryesisht diskutime në grup për tema sociale dhe aktivitete sportive, programe arti në piktur, vizatim dhe krijime artistike me objekte të ndryshme. Në shumë nga ambjentet e përbashkëta u vunë re muret e pikturuara, piktura dhe punime të cilat ishin varur në muret e sallave të aktiviteteve dhe bibliotekës. Dosjet psiko-sociale ishin të plotësuar shumë mirë, me përmbledhjet nga takimet e fundit me të dënuarit, me programet individuale dhe në grup, me vlersimet e tre mujoreve dhe gjithë dokumentat e tjera mbështetëse.

6. Shërbimi Shëndetësor

Organika e sektorit të shëndetësisë përbehej nga 4 ndihmësmjekë dhe një mjek me kohë të pjesshme

Gjatë inspektimit tonë në këtë institucion si dhe në bazë të intervistave me të dënuarit, u konstatua se shërbimi shëndetësor në këtë institucion ishte relativisht i mirë dhe të paraburgosurit nuk kanë ankesa, por problemi më kryesor është mungesa e medikamenteve dhe skemës së rimbursimit të tyre.

Në momentin e inspektimit, nga ky staf u informuam se në këtë institucion ndodheshin 28 të sëmurë kronik, të cilët ishin diagnostikuar me: Diabet Mellitus, HTA Stadi i II-të, Astma Bronkiale, Psoriasis Vulgaris, Epilepsia. Këtu përfshihen edhe 8 të paraburgosur me çrregullime mendore të formave të Çrregullimeve Bipolare, të Ankthit si dhe Skizoafektive. Ndërsa persona abuzues me substancat narkotike ishin 20, por vetëm tre prej tyre merrnin Metadon.

Nga të gjithë personat që ndodheshin në këtë institucion vetëm 180 ishin të pajisur me librezat shëndetësore, pjesa tjetër ishte në proces të plotësimit të dokumentacionit përkatës. Megjithëse ekziston një kontratë tre paleshe për sigurimin e medikamenteve për të sëmurët kronik, skema e rimbursimit të ilaçeve nuk funksionon në këtë institucion. Rrjedhimisht nga mungesa të

theksuara në medikamente, si ato të urgjencës ashtu dhe ato për të sëmurët kronik. Në shumicën e rasteve mjekimet merren privatisht nga familjarët.

Konsultat jashtë institucionit zhvilloheshin pa pengesa apo/dhe vonesa në bashkëpunim me poliklinikën dhe spitalin e rrethit.

Në dhomën e stomatologut mungonin të gjitha instrumentet dhe materialet dentare për ofrimin e një shërbimi sa më efikas.

Nga këqyrja e dokumentacionit të stafit mjekësor e në veçanti ai i mjekut u konstatua ekzistenca e një regjistri vizitash, themeltar, regjistri për konsultat jashtë institucionit, si dhe regjistri i evidentimit të rasteve të dhunës. Të gjithë formatet e kontrollit mjekësor ishin të mbajtura me rregull. Regjistrat e informacionit 24 orësh të infermiereve, gjithashtu. Kartelat mjekësore mbaheshin të mbyllura me çelës, ato plotësoheshin me rregull.

Nga inspektimet tona brenda në dhoma (dhoma 22, kati II) u kontaktua dhe një i sëmur me gur në veshka i cili para se të fillonim inspektimin ishte dërguar në spitalin e Elbasanit për të marrë ndihmën e nevojshme mjekësore. Në momnetin që i paraburgosuri u kontaktua ishte më i qetë, kishte marrë shërbimin e nevojshëm, recetën me mjekime të cilat do t'ia sillte mjeku në dhomë. Për momnetin gjendja e tij ishte e mirë dhe vetë ai pohoi se kujdesi shëndetësor nuk i kishte munguar dhe i ishte dhënë në momentin e duhur.

Të sëmurët me probleme të shëndetit mendor mbaheshin në dhoma më vete në ato raste kur ishin problematik dhe shfaqnin kriza p.sh. rasti i E. B dhoma nr.17 i cili mbahej në një dhomë më vete me mjekim të detyruar.

7. Punësimi

IEVP Elbasan ofron punësim, por të paraburgosurit nuk paguhen për punën e kryer në institucion. Ky paraburgim nuk njih as uljen e katër ditëve në muaj nga dënimi për punën e kryer. Të paraburgosurit që punojnë në institucion nuk janë të informuar për faktin se ata nuk do të përfitojnë ulje nga dënimi.

8. Masat mbrojtëse

Nga verifikimi dhe inspektimi i dokumentacioneve cdo gjë regjistrohej në regjistrin përkatës dhe protokollohej. Regjistrat mbaheshin nga sekretarja e protokollit në një zyrë të vecantë.

Sistemi ankesë / kërkesave funksiononte dhe ekzistonin të gjitha format e gatshme të kërkesë ankesave të cilat mbaheshin nga stafi i edukimit. për një ankesë/kërkesë të paraburgosurit në këtë IEVP, plotësonin një formular kërkesë/ankese dhe ia dorëzonin më pas edukatorit në zarf ose jo. Ky i fundit i dërgonte në protokoll. Pas protokollimit i kalonin Drejtorit të Institucionit, i cili kthente përgjigje me shkrim, apo i takonte të dënuarit, sipas legjislacionit në fuqi. Megjithatë, grupi i inspektimit konstatoi se pothuajse në të gjitha seksionet e regjimit mungonin kutitë e ankesave/kërkesave dhe cdo dokument përcillej dorazi. Dosjet psiko-sociale ishin të plotësuara shumë mirë, me përmbledhjet nga takimet e fundit me të dënuarit, me programet individuale dhe në grup, me vlersimet e tre mujoreve dhe gjithë dokumentat e tjera mbështetëse.

Dhomat e veçimit dhe izolimit ishin në katin e parë të godinës dhe rezultuan të ishin të mbipopulluara dhe të pa pajisura me mjetet e nevojshme për

akomodim. Këto dhoma ishin të monitoruara me kamera vëzhgimi. Gjendeshin 2 dhoma observimi dhe 2 dhoma tranziti. Në momnetin e inspektimit tek dhomat e observimit ndodheshin 6 persona përkatësisht të ndarë 2 tek një dhomë dhe 4 persona të tjerë në dhomën tjetër. Këto dhoma janë mjaft të vogla dhe në secilën prej tyre ka vetëm nga dy shtretër dhe dyshek. Në observim mungonin karrige, çërçaf, batanije dhe jastëk. Në dhomën ku gjenden katër persona 2 prej tyre flenë bashkë në tokë në një dyshek. Brenda një koridori të vogël jashtë ndodhej tualeti dhe dushet për dhomat e observimit dhe tranzitit.

Të arrestuarit në observim gjatë bisedave kofidenciale u ankuan për mungesën e enëve të kuzhinës si pjata, lugë dhe got. Ushqimin ju ishte ofruar për të gjitha oftet por ata kryesisht kishin preferuar ta merrnin nga familjarët. Ata kishin 3 ditë në obdervim dhe nuk kishin bërë as ajrim as dush.

Po atë ditë gjatë inspektimit u konstatuan dy masa disiplinore në vecim. Me datë 13/06/2014 kishte patur një konflikt mes dy të rinjv Florid Hasani dhe Renato Cala, të cilat figuronin si masë disiplinore në regjistër. Ndaj dy të paraburgosurve ishte marrë masë disiplinore me vecim për 20 ditë përjashtim nga të gjitha aktivitetet e përbashkëta. Të dy këta persona pasi janë kontrolluar dhe kanë dalë në ajrim kanë gjuajtur me grushta të Paraburgosurin Altin Cobo. Ata u pyetën nga ne dhe gjatë bisedës na pohuan se për arsye personale konflikti i tyre ishte i hershëm dhe ne thjesht donim të sqaronim gjërat. Ky konflikt ishte shmangur në kohën e duhur pa i shkaktuar lëndime të paraburgosurit Altin Cobo. Të paraburgosurve në veçim nuk ju ishte dhënë një kopje e masës disiplinore dhe sipas stafit të edukimit kjo kopje i bashkangjitej dokumentave të tyre dhe futen në dosjen psiko-sociale.

Për sa i përket takimeve ka dy ambjente ne të cilat të paraburgosurit mund të takohen me familjarët e tyre. Keto ambjente janë të ndara me xham ku familjarët e të paraburgosurit qëndrojnë përtej xhamit dhe ata komunikojnë me anë të telefonit me njëri tjetrin. Kur të paraburgosurit kanë fëmijë nën tre vjeç ose prindër të moshuar, takimet mund të zhvillohen në dhomën ku bëhen takimet me avokatin. Nuk kishte ankesa prej të paraburgosurve për sa i përket takimeve, ato zhvillohen në rregull sipas planifikimeve dheurvejoheshin në distancë nga punonjës të sigurimit. Telefonat punonin në cdo kohë dhe të dënuarit e intervistuar, pohuan se mund të flisnin sa herë të dëshironin me të afërmit e tyre nëpërmjet telefonave me kartë që ndodheshin në mjedisin e regjimit, pranë të cilëve, nuk kishte numra telefoni për Avokatin e Popullit. Megjithatë, ankesa të shumta pati lidhur me kartat e telefonit (Mobitel), për të cilat pretendohet se shpenzimi ishte më i madh se me ofruet të tjerë shërbimi telefonie, gjë që rëndonte në xhepat e të burgosurve/paraburgosurve. Sa i përket çështjes së sigurisë, në regjim kishte kamera të jashtme dhe të brendshme qëurvejonin institucionin për 24 orë.

Gjatë inspektimit në ambjentet Brenda institucionit u vu re se në muret e institucionit nuk janë të afishuar numrat e telefonit dhe adresat e Avokatit të Popullit dhe OJF-ve që meren drejtëpërsëdrejti me të drejtat e personave të dënuar dhe të paraburgosur por ato gjenden në sallën e këshillimit dhe që aty të gjithë të dënuarit marrin kontaktet sipas nevojës.

9. Takimi përmbledhës dhe rekomandimet:

Në fund të vizitës u zhvillua një takim përmbyllës me Zv/Drejtorin e IEVP Elbasan, me të cilin u biseduan të gjitha çështjet e konstatuara gjatë inspektimit dhe të cilat do të prezantohen në raport dhe për të cilat Zv/Drejtori në emër të institucionit u angazhua për përmirësimin e çështjeve të tilla si: përmirësimi i kushteve të dhomave të observimit dhe vecimit, ajrimi për të paraburgosurit me masa disiplinore; informimin e të paraburgosurve për vendimin e komisionit disiplinor dhe dhënien e një kopje të këtij vendimi të paraburgosurit; etj.

Për sa më sipër dhe në mbështetje të pikës 3, të nenit, 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”*; të nenit 21, gërma “b” të ligjit nr.8454 dt.04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku thuhet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive; si dhe në bazë të Nenit 74/1 pika “b” të Ligjit Nr. 9888 dt. 10.03.2008 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 8328 dt. 16.04.1998 Për të drejtat dhe trajtimin e të dënurave me burgim”* ku parashikohet midis të tjerash se: *“Avokati i Popullit nëpërmjet Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës ka këto kompetenca:*

b) paraqet rekomandime për organet përkatëse, me qëllim që të përmirësohet trajtimi dhe kushtet e individëve që u është hequr liria dhe të parandalohet tortura dhe trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor dhe poshtërues”.

REKOMANDOJMË:

1. Marrjen e masave të menjëhershme për uljen e mbipopullimit në IEVP-në Elbasan dhe respektimin e hapësirës personale.
2. Marrjen e masave për pajisjen, përshtatjen dhe krijimin e kushteve të jetesës sipas standardeve të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve të dhomave të observim/veçimit.
3. Marrjen e masave për krijimin e mjediseve të punës për punonjësit e sektorit të kujdesit social brenda në regjim shtimin e hapsirave ose një klase më të madhe për Godinën A..
4. Marrjen e masave që mjeku të mos jetë pjesë e Komisionit Disiplinor, pasi kjo ndikon në cilësinë e marrëdhënies mjek-pacient. Në mënyrë që mjeku të sigurojë që masa disiplinore nuk cenon shëndetin e pacientit, ai duhet të të ndjekë së paku një herë në ditë gjendjen shëndetësore të të burgosurit me masë disiplinore, dhe në çdo rast kur vlerëson se shëndeti i të burgosurit vihet në rrezik si rrjedhojë e qëndrimit në izolim, të informojë Drejtorin e Institucionit, sikurse parashikohet në Rekomandimin e CPT-së për Shqipërinë në vitin 2010.
5. Marrjen e masave urgjente për shtimin në organikë e mjekut me kohë të plotë në sektorin shëndetësor.
6. Marrjen e masave për pajisjen e të gjithë të paraburgosurve me libereza shëndetësore, duke përshpejtuar procedurën e plotësimit me

- dokumente përkatëse edhe në rastet e transferimeve nga një IEVP në tjetrën.
7. Marrjen e masave të menjëhershme për vënien në zbatim të skemës së rimbursimit të ilaçeve.
 8. Marrjen e masave të menjëhershme për furnizimin e dhomës së stomatologut me instrumente dhe materialet dentare.
 9. Pajisja dhe përmirësimi i cilësisë së rrobave të fjetjes si çarçafëve, jastikëve dhe batanijeve për të gjithë të paraburgosurit;
 10. Tu njihet të paraburgosurve 4 ditëshi i uljes së dënimit për të ata që punësohen brenda institucionit.
 11. Marrjen e masave për krijimin e mjediseve të punës për punonjësit e sektorit të kujdesit social brenda në regjim shtimin e hapsirave ose një klase më të madhe për Godinën A.
 12. Përdorimin e lavanderis për larjen e ndërresave dhe teshave të tjera të të paraburgosurve;
 13. Akomodimin e të paraburgosurve me problem të shëndetit mendor në një seksion të vecantë.
 14. Respektimin e procedurës për komisionet disiplinore, procedurë që kërkon pajisjen e të paraburgosurit me një kopje të vendimit të komisionit si dhe informimin e tij për munëdsinë e ankimit te drejtori i institucionit dhe/ose në gjykatë.
 15. Mbajtja hapur e dhomës së aktiviteteve jo vetëm gjatë orarit të paradites por edhe për aktivitete pasdite.
 16. Pastrimin e dhomave të vecimit dhe ofrimin e shërbimit në këto dhoma në mënyrë dinjitoze, pajisja e tyre me mjetet e nevojshme.
 17. Afishimin e menusë javore të miratuar në kuzhinën e institucionit, si dhe mundësisht të afishuar brenda në seksione në fillim të cdo jave.
 18. Krijimin e mundësive për vënien në zbatim të pjesës së Kuzhinës së programuar për përgatitjen e ëmbëlsirave si një mundësi programi dhe formimi profesional për të paraburgosurit;

Për qëndrimin dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor sipas nenit 22 të Ligjit Nr. 8454 dt.04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit".

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.

AVOKATI I POPULLIT

Igli TOTOZANI

Në Mungesë dhe me Porosi

K O M I S I O N E R I

Arben SHKËMBI

